

BAHRI BECI

## RRETH PARIMIT TRADICIONAL HISTORIK NË DREJTSHKRIMIN E SHQIPES

«Rregullat e drejtshkrimit të shqipes (projekt)», botuar më 1967, të cilat po i nënshtrohen diskutimit në këtë Kongres shënojnë një etapë të re në luftën për stabilizimin dhe njësimin e normës drejtshkrimore të gjuhës letrare kombëtare.

«Rregullat e drejtshkrimit të shqipes (projekt)» kanë përvetësuar gjithshka pozitive që është krijuar në sajë të përpjekjeve të disa brezave levruesish e studjuesish në luftën për unifikimin e normës drejtshkrimore të shqipes, duke zhvilluar dhe çuar më tej traditën e shkrimit të gjuhës sonë.

Ato kanë ruajtur dhe zhvilluar më tej në radhë të parë parimin themelor të drejtshkrimit të gjuhës shqipe të formuluar që më 1917 në «Rregullat mbi ortografinë e gjuhës shqipe të shkrueme të vendosuna prej Komisionit Letrarisht». Atje është shkruar që «Orthografija e gjuhës (shqipe — B. Beci), do të jetë fonetike d.m.th. gjuha do të shkruhet ashtu si flitet prej popullit...».

Ky thelb racional ka fituar një përmbajtje të re në kushtet e një realiteti të ri gjuhësor dhe të një shkence gjuhësore shqiptare të zhvilluar.

Kuptimi mbi parimin themelor të drejtshkrimit të shqipes është pasuruar me një element të ri, me fonemën.

Pikëpamja e formuluar në «Rregullat», sipas së cilës «Parimi themelor i drejtshkrimit të shqipes është parimi fonetik, fjalët shkruhen ashtu si shqiptohen», është për t'u kuptuar kështu, që drejtshkrimi ynë paraqet fonemat e gjuhës letrare, d.m.th. ata tinguj të gjuhës letrare që kanë aftësinë të dallojnë një fjalë nga një tjetër ose format gramatikore të po asaj fjale. Variantet pozicionale dhe kombinatorë të fonemave të gjuhës letrare, që janë të paaferta të dallojnë fjalët ose format gramatikore të tyre, nuk pasqyrohen. Në këto rrethana do të ishte më e përshtatshme të pohonim që *parimi themelor i drejtshkrimit të shqipes është parimi fonematik* fjalët shkruhen në pajtim me përbërjen fonematike të tyre. Kjo nuk do të thotë aspak që në hartimin e drejtshkrimit të shqipes nuk merret parasysh shqiptimi, përkundrazi në shumicën dërmuese të rasteve në mbështetjen në shqiptimin real të fonemave. Mirëpo shkrimi fonematik, në dallim nga shkrimi fonetik, përveç veçorive artikulative dhe akustike të tingujve, merr parasysh edhe aspektin funksional të tyre. Pra, ndërsa parimi fo-

netik mbështetet në lidhjen e shkronjave dhe të tingujve, parimi fonematik mbështetet në lidhjen e shkronjave dhe të fonemave. Shkrimi fonematik i përgjigjet natyrës shoqërore të gjuhës.

Shkrimi fonematik, si rezultat i ruajtjes së njësisë së fonemave, ruan edhe njësinë e morfemave. Nga kjo pikëpamje parimi fonematik është i lidhur ngushtë me parimin morfologjik, sipas të cilit «ruhet po ai kompozicion grafemik i morfemave në fjalë të prejardhura prej të njëjtës rrënjë ose në format e ndryshme gramatikore të së njëjtës fjalë, pavarësisht nga ndonjë ndryshim në shqiptimin e tyre». Ka edhe një pikëpamje të dytë, sipas së cilës «parimi morfologjik shfrytëzohet për të dalluar në shkrim kategori të tilla morfologjike që fonetiki nuk dallohen», po kjo paraqitet më e veçuar në gjuhësinë e përgjithshme.

Shkrimi i së njëjtës fjalë mund të jetë edhe fonematik edhe morfologjik. Megjithatë kjo nuk do të thotë aspak që këto dy parime duhen identifikuar, përkundrazi ato duhen dalluar qartë nga njëri-tjetri si dy parime të veçanta të drejtshkrimit të shqipes.

«Rregullat e drejtshkrimit të shqipes (projekt)», në dallim nga drejtshkrimet që i paraprijnë, të cilat janë drejtshkrime të varianteve letrare dialektore, na shfaqen si të parat rregulla të drejtshkrimit të gjuhës letrare kombëtare. Ato, ndërsa pranojnë me të drejtë që drejtshkrimi i sotëm i shqipes ruan dhe zhvillon më tej çdo gjë pozitive nga tradita e shkrimit të gjuhës sonë, nuk kanë vënë në themel të tij parimin tradicional, historik ose konservativ të drejtshkrimit, që mishëron anën negative të traditës.

Ky parim, në esencë, kërkon të ruajë pa ndonjë arësye, një drejtshkrim të tillë që ka ekzistuar në periudhat e kaluara të zhvillimit historik të gjuhës dhe si i tillë nuk reflekton përbërjen e sotme fonematike të fjalëve, për shkak të ndryshimeve që kanë ndodhur që nga ajo epokë.

Si pasojë e zbatimit të këtij parimi, grafemat ose e humbasin ose e ndryshojnë referencën e tyre fonematike. Parimi tradicional historik nuk mund të pranohet si parim i gjuhës së shkruar të sotme, derisa pasqyron fenomene të sistemeve gjuhësore të epokave të kaluara. Zbatimi i tij sjell rritjen e vazhdueshme të tepricave në drejtshkrim, d.m.th. të paraqitjes së të njëjtës fonemë me grafema të ndryshme dhe krijon grafema të qeta.

Mendimi i shfaqur gjatë diskutimit popullor të «Rregullave», sipas të cilit: «Për të gjitha gjuhët që kanë një letërsi të vazhduar krijohet një traditë shkrimi. Jashtë kësaj tradite këto gjuhë nuk sigurojnë dot një drejtshkrim të njësuar. Shqiptimi mund të shërbejë si parim themelor vetëm për fjalët e reja e derivatet e tyre», e kërkon burimin e unitetit të drejtshkrimit jo në realitetin e sotëm gjuhësor po në zbatimin e parimit tradicional, historik ose konservativ. Një vlerësim i tillë i problemit nuk merr parasysh faktin që, gjuha është një fenomen shoqëror që zhvillohet vazhdimisht. Drejtshkrimi si pasqyrim i drejtpërdrejtë i saj nuk është një kategori statike po një kategori dinamike, që ndryshon së bashku me ndryshimin e gjuhës.

Është shkruar p.sh. që «pavarësisht nga shqiptimi në gjuhën letrare, për përdorimin e ë-së do të ruajmë traditën e shkrimit, se vetëm

në bazë të kësaj tradite mund të sigurojmë një ortografi gramatikore të drejtë dhe pa lëkundje».

Por kjo nuk na duket të jetë rruga më e mirë për të siguruar një ortografi «të drejtë» dhe «pa lëkundje». Edhe më parë, për shkak të mospërputhjes me realitetin gjuhësor ë kemi mënjanuar shkrimin e ë-së fundore në pjesën dërmuese të fjalëve proparoksitone dhe kemi bërë mirë. Asnjëri nuk do ta përshëndeste sot ruajtjen e ë-së fundore në fjalët proparoksitone të tipit *Luletë e Verësë*, meqënëse kështu shkruhej në kohën e Rilindjes.

Duke shqyrtuar gjerësinë e zbatimit të parimit fonematik dhe lidhjet e tij me parimin tradicional, historik në drejtshkrimin e shqipes vimë te një pikë sa e rëndësishme aq edhe e vështirë.

Kur shkruajmë me ë fjalë të tilla si këto:

arësye	arë	burrë	thasë	bukurisë	drutë	i ftohtë	punojnë
bërryl	bletë	dyllë		shtëpisë		i ngrohtë	
dërrasë	dardhë	lumë		rinisë		i thatë	etj.,

nga cili parim nisemi? Mungesa e studimeve me metoda objektive të fonetikës eksperimentale për këtë problem e vështirëson zgjidhjen e tij. Mendimet që janë dhënë për këtë çështje janë kontradiktore. Një palë mendon se «prirja për të ruajtur ë-në (pa dyshim në mënyrë të reduktuar...) është një veçori e strukturës fonetike të gjuhës letrare kombëtare»; një palë tjetër mendon se «ajo është e vërtetë përse i përketë shkrimit po jo strukturës fonetike të shqipes letrare». Ndonjë tjetër i pranon të dyja si veçori të strukturës fonetike të gjuhës letrare. Po edhe sipas pikëpamjes së fundit «rasti më i rëndomtë është rasti kur ë-ja fundore është reduktuar gjer në zero dhe zanorja e theksuar është ose e gjatë ose më e gjatë se e mesmja...».

Duke vëzhguar për këtë qëllim folës në gjuhën letrare në stilin libror, kemi formuar bindjen që ë-ja fundore nuk dëgjohet në gjuhën letrare. Rastet e ruajtjes së saj si një tingull i reduktuar nuk janë sporadike në gjuhën letrare.

Ky pohim gjenë mbështetje edhe në të dhënat e dialektologjisë shqiptare. Punimet dialektologjike të këtyre viteve të fundit kanë treguar se nga pikëpamja e shtrirjes territoriale më e përgjithshme është rënja e ë-së fundore.

† Ë-ja fundore ka rënë në të folmet e Beratit, të Myzeqesë, të Mallakastrës, të Bregdetit të poshtëm, të Kurveleshit, të dialektit të jugut (të toskërishtes) dhe në të gjitha të folmet e dialektit të veriut (të gegërishtes). Në të folmen e Korçës edhe në atë të Skraparit vihen re lëkundje.

Në këto rrethana si duhet vlerësuar ë-ja fundore në sistemin grafemik të gjuhës sonë letrare, si grafemë apo si një shenjë diakritike që vlen për të shënuar shkallën e gjatësisë së zanoreve para saj?

Në qoftë se kjo e fundit është e vërtetë, atëherë ruajtja e ë-së fundore në drejtshkrimin e shqipes do të përbente një shfaqje të thyerjes së parimit fonematik për shkak të zbatimit të parimit tradicional historik në drejtshkrimin tonë, një nga pasojat e të cilit është edhe përdorimi i disa shkronjave me funksione diakritike.

Po të jetë kështu atëherë lind pyetja si duhet vlerësuar ruajtja e ë-së në fjalët e prejardhura ose të përbëra të tipit: *anëtarësi, gojëtar, pjesëtim, mirëqënje* e të tjera, ku zanorja e temës së fjalës e ka humbur gjatësinë për shkak të kalimit të saj në pozicion të pathek-suar? Edhe pikëpamja sipas së cilës ë-ja fundore në fjalët *arë, bletë, dardhë* ruhet për të dalluar në shkrim gjininë femërore të emrave në vend për diskutime.

Po që se kjo është e vërtetë atëherë si duhet vlerësuar ruajtja e ë-së fundore tek emrat e gjinisë mashkullore të tipit: *burrë, djalë, gjumë, kalë, lëmë, lumë brumë, djathë, dyllë, dhjamë, grurë, gjalpë, mjaltë, ujë*, etj. Përveç kësaj ka edhe mjaft emra të gjinisë femërore që dalin pa ë fundore si *motër, votër, flutur, votull, rrufe, shtëpi, kala*, si edhe mjaft raste kur ë-ja fundore shoqëron emrat e gjinisë femërore dhe mashkullore në shumës: *bjeshkë, buzë, dardhë, degë, fletë, këmishë, punëtorë, doktorë* si edhe kategori të tjera morfologjike.

Në këto rrethana bëhet e qartë domosdoshmëria e përcaktimit të kriterit nga i cili do të nisemi me përdorimin e ë-së fundore tek emrat, mbiemrat, përemrat, numrorët si edhe në fjalët e prejardhura e të përbëra prej tyre.

Mungesa e një kriteri të qartë në përdorimin e ë-së fundore tek këto kategori gramatikore ka sjellë rritjen e vështirësive të drejtshkrimit tonë.

Nga kjo pikëpamje besojmë se edhe më problemore paraqitet ë-ja fundore në vetën e parë dhe të tretë shumës të së tashmes së mënyrës dëftore, në vetën e tretë njëjës dhe në tri vetat e shumësit të kohës së tashme të mënyrës dëftore dhe lidhore, të cilat nga pikëpamja e vendit të theksit na paraqiten si fjalë proparoksite: (na) *shkruajmë, bluajmë, lyejmë*; (ata) *shkruajnë, bluajnë, lyejnë*; (ai) *të shkruajë, të bluajë, të paguajë*; (na) *të shkruajmë, të bluajmë, të paguajmë*; (ata) *të shkruajnë, të bluajnë, të paguajnë*. Pikëpamja, sipas së cilës ë-ja fundore në këtë kategori fjalësh ruhet për shkak të zbatimit të parimit morfologjik, për të ruajtur në të shkruar unite-tin e mbaresave *-jë, -jmë, -jnë* (krhs. me (na) *punojmë*, (ata) *punojnë*, (ai) *të punojë*, (na) *të punojmë*, (ata) *të punojnë*) nuk del gjithaq e justifikuar po të kemi parasysh që «Rregullat e drejtshkrimit të shqipes» rekomandojnë të shkruajmë pa ë fundore foljet e tipit (na) *biem, shpiem*; (ata) *bien, shpien*; (na) *të biem, të shpiem*; (ata) *të bien, të shpien* si edhe po të kemi parasysh që lejohemi të shkruajmë nga njëra anë (na) *lamë*, (ju) *latë*, (ata) *lanë* dhe nga ana tjetër (na) *mësuam, shpërblyem*; (ju) *mësuat, shpërblyet*; (ata) *mësuan, shpërblyen*.

Zbatimi i parimit fonematik është thyer edhe herë të tjera për të dalluar në shkrim kategori morfologjike, të cilat nga përbërja fonematike nuk dallohen. Për këtë qëllim është ruajtur, besojmë ne, p.sh. ë-ja fundore në vetën e tretë njëjës të së tashmes së lidhores (ai) *të lajë, të thajë* etj.. (krh. me vetën e parë (unë) *të laj, të thaj* etj.). Mirëpo kjo nuk është bërë në mënyrë konsekuente, kështu p.sh., nuk dallohen në shkrim kategori gramatikore siç janë p.sh. vetat e

njëjësit të kohës së tashme të mënyrës dëftore të foljeve që mbarojnë me bashkëtingëllore (unë *lidh*, ti *lidh*, ai *lidh*), ose veta e dytë dhe e tretë njëjës e së tashmes së dëftores të foljeve me temë më zanore të tipit ti *punon*, ai *punon*. Këto edhe shfaqje të tjera si këto të zbatimit herë të njërit parim e herë të tjetrit kanë çuar në rritjen pa nevojë të vështirësive të drejtshkrimit të shqipes, meqenëse u jepen zgjidhje të ndryshme problemeve që në të vërtetë kërkojnë zgjidhje unike. Ka edhe raste të tjera të thyerjes së parimit fonematik për shkak të zbatimit të parimit tradicional, historik. Kështu p.sh.:

1. Shkrimi me *ia*, *ie*, *io*, *iu* i fjalëve me burim të huaj të tipit *australian*, *aviator*, *piano*, *arie*, *dietë*, *kantier*, *kamion*, *leksion*, *radio*, *brigadier*, *violinë* ose *Violeta*. Për shqipen letrare nuk qëndron mendimi i parashtruar në «Rregullat» që këto fjalë shqiptohen me *ia*, *io*, *iu*. Ato nga pikëpamja e shqiptimit nuk dallohen nga grupet *ja*, *je*, *jo*, në fjalët vëndase të tipit *djalë*, *djathtas*, *mjell*, *vjel*, e *jonë* ose në fjalët me burim të huaj *objekt*, *objektiv*, *Vjenë*, *rajon*, *studjoj*, të cilat sipas «Rregullave të drejtshkrimit të shqipes» do të shkruhen me *ja*, *je*, *jo*.

Në këto rrethana na duket jo i drejtë pranimi i dy zgjidhjeve të ndryshme për diftongjet *ia*, *ie*, *io*, *iu* në gjuhën letrare. Kjo bëhet më bindëse po të kemi parasysh që në «Rregullat» fjalët e tipit *lumjan*, *matjan* ose ato të tipit *himarjot*, *vjollca* rekomandohet të shkruhen me *ja*, *jo*.

2. Shkrimi me *ë* fundore i emrave të gjinisë mashkullore të tipit *lumë*, *djalë*, *burrë*, *dyllë*, etj.

3. Shkrimi me *ë* fundore në vetën e dytë njëjës të mënyrës urdhërore të foljeve: *bie*, *shpie*, *shtie*, *zë*, *përzë*, *lë*, *vë* (*bjerë*, *shpjerë*, *zërë*, *përzërë*, *lërë*, *vërë*), si edhe të foljeve: *flas*, *hyj*, (*folë*, *hyrë*).

4. Ruajtja e *ë*-së paratheksore në fjalët e tipit: *arësye*, *arësim*, *arësimtar*, *këqyr*, *gërryej*, *dërrasë*, *bërryl* etj.

Edhe shkrimi me *ue* dhe *ye* i mbiemrave të formuar me anë të prapashtesave *-shëm* dhe *-s*: *i dëgjueshëm*, *mësues*, *ndërtues*, *submues*, përbën sipas nesh, një shfaqje të ndikimit të parimit tradicional historik.

Edhe lidhur me këtë çështje në diskutimet e bëra janë shfaqur mendime të ndryshme. Disa e pranojnë reduktimin e *ue*-së dhe të *ye*-së respektivisht në *u* dhe *y* në kategoritë e fjalëve të përmendura. Të tjerë besojnë se *ue* dhe *ye* në kët kategori fjalësh ose shqiptohen deri diku të plota ose shqiptohen me *e* të errësuar, që i afrohet një *ë*-je të reduktuar (sulmuës, i pathyëshëm).

Ne, duke vrojtuar për këtë qëllim folësit më të mirë në gjuhën letrare të Radio Tiranës në stilin letrar kemi formuar bindjen që *ue* dhe *ye* në grupin e fjalëve të zëna në gojë shqiptohen *u* dhe *y*. Rastet e ruajtjes së elementit të dytë të tyre në mënyrë të reduktuar na duket se nuk janë një fenomen i shpeshtë në gjuhën letrare.

Këto shfaqje të zbatimit të parimit tradicional historik dhe të tjera si këto rrjedhin nga marrja parasysh në mënyrë të pamjaftueshme e përbërjes fonematike të fjalëve në gjuhën e sotme letrare ose për shkak të ndikimit të traditës dhe ngurimit për t'u larguar prej saj.

Këtu vimë tek një pikë tjetër e rëndësishme dhe delikate; cili duhet të jetë qëndrimi ndaj rasteve që janë bërë traditë po që bien

në kundërshtim me parimin themelor të ortografisë sonë? Lidhur me këtë çështje mendoj se në disa raste të caktuara duhet të mos stepemi të bëjmë ndryshime në qoftë se kjo do t'i shërbejë thjeshtësimit dhe përsosjes së tyre të mëtejshme në dobi të përvetësimit të tyre më me lehtësi. Atë kohë që mund të humbasim për t'i çmësuar disa do ta fitojnë duke ua mësuar më me lehtësi atyre që do të fillojnë ta mësojnë.

Mendojmë se zbatimi konsekuent i parimit fonematik si rezultat i njohjes shkencërisht të saktë me mjete edhe të fonetikës eksperimentale të përbërjes fonematike të fjalëve të gjuhës letrare dhe zvogëlimi i rrezes së veprimit të parimit tradicional historik në drejtshkrimin e shqipes do të ishte një nga rrugët më kryesore drejt së cilës duhet shkruar në përpjekjen për ta thjeshtuar e përsosur drejtshkrimin tonë.

Ecja në këtë rrugë për thjeshtimin dhe përsosjen e mëtejshme të «Rregullave të drejtshkrimit të shqipes» do të bëjë të mundur arritjen në një kohë sa më të shkurtër të njësimimit të plotë të gjuhës letrare kombëtare. Në këtë mënyrë gjuha letrare shqipe do të funksionojë si një mjet edhe më i fuqishëm për zhvillimin e kombit tonë socialist.